



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.68

1 qershor

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Rezolutë e Kuvendit datë 20.5.2010	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2009	2579
Rezolutë e Kuvendit datë 20.5.2010	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2009	2580
Vendim i Kuvendit nr.34, datë 20.5.2010	Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi	2581
Vendim i Kuvendit nr.35, datë 20. 5.2010	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin e kuvendit nr.68, datë 20.2.2003 “Për mënyrën e trajtimit të deputetëve”, të ndryshuar	2584
Vendim i Kuvendit nr.36, datë 20.5.2010	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zonjës Altina Xhoxhaj anëtare e Gjykatës Kushtetuese	2585
Vendim i Kuvendit nr.37, datë 20.5.2010	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Bashkim Dedja anëtar i Gjykatës Kushtetuese	2585
Vendim i Kuvendit nr.38, datë 20.5.2010	Për mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Vangjel Kosta anëtar i Gjykatës Kushtetuese	2586

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2009

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 103 të Rregullores së Kuvendit, pasi u njoh me Raportin për Veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2009, konstaton se:

- Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës është ushtruar në përputhje me kërkesat e nenit 164 të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndryshuar me ligjin nr. 9499, datë 3.4.2006.

Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës në drejtim të:

- Plotësimin dhe përmirësimin të kuadrit ligjor, duke u fokusuar në plotësimin e legjislacionit sekondar në fushën e konkurrencës, në përputhshmëri me aktet legjislative të Bashkimit Europian;

- Rritjes së komunikimit me tregjet, konsumatorët dhe publikun në tërësi, duke synuar mbrojtjen e interesave të palëve;

- Vendosijes dhe thellimit të bashkëpunimit me organizmat dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në tërheqjen e politikave më të mira apo ofrimin e asistencës teknike të nevojshme.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2010 të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Rritjen dhe konsolidimin e pozicionit të Autoritetit për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve;

- Nxitjen e konkurrencës së lirë dhe mbrojtjen e konsumatorëve, nëpërmjet ndërmarrjes së hetimit në tregun e tranzitimit dhe interkoneksionit në komunikimet elektronike, importit dhe të shitjes me shumicë të karburanteve, importin e grurit, miellit dhe prodhimit të bukës, tregun e bonove të thesarit, tregun e sigurimit të detyrueshëm TPL etj.;

- Plotësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor e nënligjor të institucionit, në përputhje me praktikën e vendeve të tjera dhe direktivat e Bashkimit Europian;

- Përfundimin e hetimeve të nisura, si dhe zgjerimin e thellimit të hetimeve në tregje, për të eliminuar deformimet e konkurrencës dhe për të mbrojtur konsumatorët;

- Rritjen e efikasitetit të ndërhyrjeve në tregjet ku shfaqen shenjat e kufizimit të konkurrencës, nëpërmjet përsosjes së teknikave investigative;

- Rritjen e profesionalizmit dhe përafrimin me standardet e autoriteteve homologe, në mënyrë që të forcohet pavarësia e institucionit;

- Rritjen e advokacisë së konkurrencës, duke forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional;

- Rritjen e kulturës për ligjin dhe politikën kombëtare të konkurrencës, duke promovuar partnerшипin dhe bashkëpunimin, kryesisht me komunitetin e biznesit;

- Ndërgjegjësimin e aktorëve të ndryshëm dhe publikut për rëndësinë e konkurrencës dhe rolin e Autoritetit në ruajtjen e saj, si dhe bashkëpunimin me ta në këtë proces.

Kuvendi u kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës:

- Në dhënien dhe shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për monitorimin e tregut dhe hetimin e praktikave që deformojnë konkurrencën në treg;

- Për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

20 maj 2010

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE PËR VITIN 2009

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

- Duke njohur e vlerësuar rolin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për mbikëqyrjen e tregjeve financiare jobankare në Republikën e Shqipërisë;

- Duke vlerësuar kontributin e tij në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së këtyre tregjeve;

- Duke vlerësuar rolin e këtij autoriteti për t'i siguruar Kuvendit, drejtuesve të institucioneve shtetërore dhe publikut, në përgjithësi, një informacion cilësor e profesional mbi këto tregje;

- Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në drejtim të:

- Përmirësimin të kuadrit ligjor ekzistues, duke reflektuar kështu zhvillimet më të fundit të legjislacionit europian, që rregullojnë tregjet financiare jobankare, në përputhje me planin kombëtar të zbatimit të MSA-së, si dhe duke forcuar rolin e Autoritetit, në kuadër të funksionit të tij rregullues;

- Përdorimit të elementeve të reja të modelit të mbikëqyrjes me bazë risku, të cilat ndihmojnë në analizimin e gjendjes financiare dhe treguesve të operatorëve financiarë;

- Projektimit, ndërtimit dhe administrimit të sistemeve informatike, në mbështetje të strategjisë së Autoritetit, për përmbushjen e nevojave të mbikëqyrjes së tregut, operatorëve të tij dhe mbrojtjen e konsumatorëve;

- Rritjes së cilësisë dhe transparencës së informacionit për një komunikim më efektiv me publikun në tërësi, me qëllim mbrojtjen e interesave të të siguruarve, si dhe edukimin e segmenteve të ndryshme të tregut dhe të konsumatorëve për produktet financiare të institucionit;

- Vendosjes dhe thellimit të bashkëpunimit me organizmat dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në tërheqjen e politikave më të mira apo ofrimin e asistencës teknike të nevojshme.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2010 të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Rritjen dhe konsolidimin e pozicionit të Autoritetit në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare jobankare;

- Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, duke garantuar, në të njëjtën kohë, edhe sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur;

- Plotësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor e në veçanti atij nënligjor, në zbatim të akteve ligjore të miratuara deri tani, në përputhje me praktikat e vendeve të tjera dhe direktivat e Bashkimit Europian;

- Përgatitjen e kuadrit ligjor dhe marrjen e masave organizative, me synim përmirësimin e raportit dëme/prime;

- Nxitjen e fushatave edukuese për publikun, që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit për përfitimet nga produktet dhe shërbimet financiare, në funksion të rritjes së efektivitetit dhe integritetit të tregjeve;

- Krijimin e hapësirave të nevojshme, që lehtësojnë hyrjen e investitorëve dhe kapitalit të huaj në tregjet financiare jobankare.

20 maj 2010

VENDIM
Nr.34, datë 20.5.2010

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË
POZICIONEVE TË PUNËS TË ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 21 të ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe të neneve 9 e 10 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi,


KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Miratohet struktura e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur.
- II. Miratohet organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të Zyrës së Komisionerit nga Diskriminimi, sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur.
- III. Paga e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është në raportin 0,66 të pagës së Presidentit të Republikës së Shqipërisë.
- IV. Efektet financiare të pagës së Komisionerit fillojnë nga çasti i marrjes së detyrës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

**STRUKTURA E ZYRËS SË KOMISIONERIT
PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**



Lidhja nr.2

**ORGANIKA DHE KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS
TË ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Funksioni	Nr. i punonjësve	Kategoria/Klasa
I. Komisioneri	1	
Këshilltar	1	II - b
Sekretar/specialist arkiv-protokolli	1	IV - a
II. Drejtoria e Çështjeve Procedurale, Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë	(6)	
Drejtor	1	II - b
Specialistë	5	III - b
III. Drejtoria e Hetim - Inspektimit	(5)	
Drejtor	1	II - b
Inspektorë	4	III - b
IV. Sektori i Marrëdhënieve me Publikun	(2)	
Përgjegjës sektori	1	III - a/1
Specialist	1	IV - a
V. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse	(7)	
Drejtor	1	II - b
Specialist i burimeve njerëzore	1	IV - a
Specialist financë-buxhet	1	IV - a
Specialist IT	1	III - b
Magaznier/ punonjës mirëmbajtjeje	1	Kl. (VKM 717, dt.6.2009)
Shofer	1	Kl. “
Pastrues	1	Kl. “
Gjithsej	23 punonjës	

VENDIM
Nr.35, datë 20. 5.2010

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.68, DATË
20.2.2003 “PËR MËNYRËN E TRAJTIMIT TË DEPUTETËVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999 “Për statusin e deputetit”, të ndryshuar, si dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e sekretariateve për statusin e deputetit dhe për buxhetin,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr.68, datë 20.2.2003 “Për mënyrën e trajtimit të deputetëve”, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

I. Në pikën 1, fjalia e dytë zëvendësohet me fjalitë e mëposhtme:

“Raportet e përbërësve të pagës mujore të deputetit janë si më poshtë:

- a) 40 % të pagës për pjesëmarrjen në seancë plenare;
- b) 50 % të pagës për pjesëmarrje në mbledhjet e komisioneve të Kuvendit,
- c) 10 % të pagës për pjesëmarrje në veprimtari të tjera parlamentare.

Mospjesëmarrja e deputetit në mbledhjet e komisioneve të përhershme të Kuvendit apo seancë plenare passjell ndalesën e pjeshme të pagës, sipas shkronjave “a” dhe “b”, në përputhje me frekuentimin e tij në to për një muaj. Në rastet e moszhvillimit të mbledhjes së komisionit, për shkak të mungesës së kuorumit, deputetët e pranishëm përjashtohen nga ndalesa e pagës për këtë mbledhje.”.

II. Pas pikës IV shtohet pika V me këtë përmbajtje:

“V. Raportet e pagës, të parashikuara në pikën 1 të vendimit, zbatohen edhe për përfitimet e tjera që ka deputeti, si: dieta, shpenzime transporti, shërbime telefonike apo shpenzime për strehimin, të cilat i paguhen deputetit përpjesëtimisht me pjesëmarrjen e tij në mbledhjet e komisioneve të përhershme apo seancë plenare.”.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.36, datë 20.5.2010

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZONJËS
ALTINA XHOXHAJ ANËTARE E GJYKATËS KUSHTETUESE

Në mbështetje të neneve 78 e 125 të Kushtetutës dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr.6558, datë 13.5.2010 dhe në dekretin e Presidentit të Republikës nr.2027, datë 26.3.1998,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dhënien e pëlqimit për emërimin e zonjës Altina Xhoxhaj anëtare e Gjykatës Kushtetuese, në vend të zotit Kujtim Puto, pas mbarimit të mandatit të tij.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.37, datë 20.5.2010

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZOTIT
BASHKIM DEDJA ANËTAR I GJYKATËS KUSHTETUESE

Në mbështetje të neneve 78 e 125 të Kushtetutës dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr.6559, datë 13.5.2010 dhe në vendimin e Kuvendit nr.358, datë 23.4.1998 pika 1,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Bashkim Dedja anëtar i Gjykatës Kushtetuese, në vend të zotit Fehmi Abdiu, pas mbarimit të mandatit të tij.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.38, datë 20.5.010

PËR MOSDHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZOTIT
VANGJEL KOSTA ANËTAR I GJYKATËS KUSHTETUESE

Në mbështetje të neneve 78 e 125 të Kushtetutës dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr.6560, datë 13.5.2010,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Vangjel Kosta anëtar i Gjykatës Kushtetuese.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 1.6.2010

Doli nga shtypi më 1.6.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 12 lekë